

Marrëveshje Bashkëpunimi

ndërmjet

Ministrisë së Shëndetësisë, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

dhe

Shoqatës Italiane “the Heart of Children”

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri Z. Petrit VASILI (1);

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Ilir DASHI (2);

Shoqata “The Heart of Children” Onlus, përfaqësuar nga Presidenti, Dr. Vittorio VANINI (3) dhe Bashkëpunëtorët Operativë Dr. Italo BORINI (4) dhe Z. Giuseppe GHISLANDI (5)

Palët pjesëmarrëse (1,2,3, 4, 5) që në vijim do të quhen “Palë nënshkruese”,
duke konsideruar, si më poshtë:

Që shoqata “the Heart of Children”, është një shoqatë jo fitimprurëse me dobishmëri sociale e cila ofrohet të ndihmojë me të gjithë mjetet në dispozicion edhe nëpërmjet caktimit të bashkëpunëtorëve operativë në zhvillimin e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë pediatrike, aty ku nevojitet ndihmë, në mënyrë që, brenda mundësive pjesa më e madhe e fëmijëve kardiopatë të mund të kurohet në vend.

Që bashkëpunëtorët Operativë të Shoqatës, kryejnë një punë me nivel të lartë specialiteti, nën mbikqyrjen e Shoqatës, që do të thotë pa asnjë përfitim, por me një pavarësi të plotë në aftësitë e tyre profesionale.

Që, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, është e pajisur me një Qendër të Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë, e cila funksionon më së miri në trajtimin e pacientëve të rritur dhe dëshiron të provojë potencialin e saj në Kardiokirurgjinë dhe Kardiologjinë Pediatrike, nëpërmjet bashkëpunimit me Entë dhe Konsultë Italiane,

bien dakord dhe nënshkruajnë si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Palët nënshkruese bien dakord të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre, të krijojnë një kuadër të favorshëm për bashkëpunimin sipas vullnetit të tyre të përbashkët dhe të përshpejtojnë formalitetet, me qëllimin e realizimit të shërbimeve kardio-kirurgjikale tek fëmijët në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” si dhe veprimtarive të tjera të përcaktuara në nenet 2, 3 e në vijim të kësaj marrëveshje.

Palë nënshkruese për Shoqatën do të jenë:

Presidenti i Shoqatës “the Heart of Children”, Dr. Vittorio Vanini, në cilësinë e mbikëqyrësit dhe operuesit në sektorin e kompetencës së tij.

Konsulentët Dr. Italo Borini dhe Z. Giuseppe Ghislandi, në degën e specialitetit përkatës, në cilësinë e profesionistëve me autonomi të plotë profesionale.

Neni 2

Objektivat në Kardiokirurgjinë Pediatrike

Konsulencë në kardiokirurgjinë pediatrike dhe teknikën e perfuzionit tek fëmijët.

Shkëmbim njohurish mjekësore në kardiokirurgjinë pediatrike.

Trajnim i personelit mjekësor dhe paramjekësor shqiptar.

Organizimi i seminareve, kongreseve dhe simpoziumeve.

Neni 3

Detyrimet e “the Heart of Children”

Shoqata “the Heart of Children”, do të impenjohet në promovimin e një bashkëpunimi të vazhdueshëm në fushën e kardiokirurgjisë pediatrike. Ky bashkëpunim do të kryhet nga një skuadër e specializuar, e zgjedhur nga vetë Shoqata, e cila do të përbëhet nga kardiokirurgë, anestezistë, teknikë perfuzionistë, infermiere terapie intensive, sipas nevojave të palës tjetër.

Në këtë kuadër do të konsiderohen Konsulentë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, specialistët e mëposhtëm:

1. Prof. Vittorio Vanini, Kryesues i Grupit dhe President i Shoqatës “the Heart of Children”, Kardiokirurg Pediatër.
2. Dr. Italo Borini, Kardiokirurg Pediatër i Institutit Giannina Gaslini të Genovës, i cili do të kryejë të gjitha funksionet e Prof. Vaninit në mungesë të tij.

3. Z.Giuseppe Ghislandi, i cili do të jetë përgjegjës për Qarkullimin Ekstrakorporal.

Partnerët italianë, sipas fushave të tyre të specializimit, do të kenë këto të drejta dhe detyrime gjatë periudhës së Marrëveshjes:

1. Kryerjen e aktivitetit të konsulencës çdo 4 (katër) muaj, për të paktën një periudhë kohe prej 7(shtatë) ditësh pune.
2. Përcaktimin e indikacioneve kirurgjikale dhe terapeutike dhe programit të operimeve, së bashku me skuadrën shqiptare, gjatë periudhës së qëndrimit.
3. Kryerjen personalisht të ndërhyrjeve të përcaktuara, në marrëveshje me skuadrën shqiptare, ose asistimi i kirurgëve shqiptarë, sipas vështirësive të rastit.
4. Garantimin e cilësisë dhe standardeve për të gjitha procedurat terapeutike dhe kirurgjikale.
5. Sugjerimi i materialeve dhe instrumentave, që duhet blerë, në rast se do të jenë të nevojshme, për zhvillimin normal të këtyre specialiteteve.
6. Të marrin pjesë me të drejtë të plotë në aktivitetet klinike dhe shkencore të Shërbimit të Kardiokirurgjisë.
7. Harmonizimin e aktiviteteve praktike nëpërmjet mësimave formuese, shkëmbimit të eksperiencës dhe eventualisht kurse trajnimi në Institutet Italiane. Trajnimi i personelit do të bëhet në bashkëpunim me “International Heart School” të Bergamos, të drejtuar nga Prof. Lucio Parenzan.

Neni 4

Detyrimet e Palës Shqiptare

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, impenjohet të:

Ftojë në bashkëpunim, Konsulentët italianë dhe skuadrën e Shoqatës si në planin organizativ ashtu dhe në atë teknik e të sigurojë kushtet thelbësore të ushtrimit të aktivitetit kardiokirurgjikal.

Të kryejë shpejt formalitetet, derisa skuadra të mund të ushtrojë ligjërisht aktivitetin në kujdesin mjekësor dhe kirurgjikal, në spitalin e sipërpërmendur, ose në të tjera për të cilat do të bihet dakord, dhe ti jepet siguri, për sa i përket përgjegjësiave civile, personave të sipërpërmendur.

Të respektojë pikat e Nenit 5 (në vijim), për burimet financiare.

Neni 5

Burimet Financiare

Duke parë se, Shoqata “the Heart of Children” është një shoqatë humanitare dhe të gjithë anëtarët e saj punojnë dhe impenjohen pa patur objektiv fitimin, pala shqiptare detyrohet të:

Ministria e Shëndetësisë impenjohet të mbulojë:

- Garantimin e një sigurie totale për Konsulentin italian, në përgjegjësi civile, në fushën e aktivitetit mjekësor, objek i kësaj marrëveshje.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, impenjohet të mbulojë:

- Shpenzimet e akomodimit në hotel dhe ushqimit për skuadrën italiane, gjatë periudhës së aktivitetit të konsulencës në Tiranë, për atë kohë sa do të zgjasë Marrëveshja.
- Sigurimin e furnizimeve me materiale mjekësore të nevojshme për procedurat Kardio - kirurgjikale.

Shoqata “the Heart of Children” impenjohet të:

- Bashkëpunojë për sa të jetë e mundur në furnizime me materiale mjekësore të nevojshme në ndërhyrjet kardiokirurgjikale.
- Garantojë siguri totale anëtareve të ekipit, në rast incidenti, gjatë zhvillimit të misionit humanitar në Shqipëri.

Neni 6 Ndryshime

Çdo përshtatje, shkrirje, modifikim ose ndryshim i tekstit të kësaj marrëveshje, kërkon aprovimin me shkrim të palëve.

Neni 7 Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj.

Neni 8 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një vit dhe do të rinovohet automatikisht nëse nuk paralajmërohet anulimi nga njëra prej “Palëve Nënshkruese”, të paktën 3(tre) muaj përpara përfundimit të afateve të vlefshmërisë.

Neni 9 Kontestime

Zgjidhja e kontestimeve të rastit, për sa i përket përkthimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshje, do të arrihet nëpërmjet diskutimeve mes palëve.

Sa më sipër u lexua, aprovua dhe u nënshkrua nga palët, në Tiranë, më datë ____/____/ 2010

Ministri i Shëndetësisë

Petrit VASILI

Drejtori i Përgjithshëm

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

Ilir DASHI

Presidenti “the Heart of Children”

Dr. Vittorio VANINI

Dr. Italo BORINI

Dr. Giuseppe GHISLANDI